



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA  
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,  
NR.6  
TEL: 693645101

# PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 2141

Nr. koleksioni: 1497

Tirane më 22/04/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 7 fletë



A2022051400168033528



## AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQERISE "SMART SOLAR" Sh.P.K.

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet kështu.*

Sot, ne Tiranë, para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6, u paraqiten personalisht:

1. **Z.ANRI LUSHNJARI**, atësia Stavri, amësia Dashmira, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje, Lushnjë dhe banues në TIRANË, me adresë Xhezmi Delli; Nd. 22; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 17/04/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034719599 dhe nr. personal I20417139W.
2. **Z.ALBJON DULE**, atësia Nizam, amësia Vitori, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë Ramis Aranitasi Nj.1; Nd. 21; Fier; Fier; 9303; Fier, lindur më 09/06/1987, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034303636 dhe nr. personal I70609087G.

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Ne përputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, ka miratuar kete Statut si vijon:

### KAPITULLI I THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA

#### Neni 1

##### Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqërisë është "SMART SOLAR" Sh.P.K.

Shoqëria "SMART SOLAR" Sh.P.K. është një person juridik privat, e themeluar në bazë të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (me pas referuar si "Ligji Tregtar") në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K.).

Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (me pas referuar si "QKR") në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqëria behet përgjegjëse kundrejt paleve të treta, për detyrimet dhe demet që shkakton gjatë veprimtarisë së saj.

Ortaket e Shoqërisë do të jenë përgjegjës kundrejt paleve të treta deri në shumën e kontributit të derdhur në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

#### Neni 2

##### Selia

Shoqëria do ta ketë selinë e saj në adresën e mëposhtme: Rruga Arban, Vaqarr-Tiranë, Zona Industriale, Tiranë.

- Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është <http://smartsolar.al>.
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [info@smartsolar.al](mailto:info@smartsolar.al)



A2022051400168033528

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

### Neni 3 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë sa vijon:

*“Tregtimi i mallrave te ndryshme, materialeve elektrike dhe elektronike speciale qe kane te bejne me tipologjine e impianteve te percaktuara si me poshte dhe ne pergjithesi te çdo produkti industrial, makinerive dhe pajisjeve, lendeve te para, te teknologjive te ndryshme, si dhe import eksport i ketyre mallrave, etj.*

*Konsulence teknike ne fusha te ndryshme, supervizion, menaxhimet dhe studimet e e gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marreveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo forma te tjera, veprimtari komisionere, servis per tipet e ndryshme te automjeteve, perfaqesim, si dhe veprime te tjera te porositura nga te tretet te lejuara nga legjislacioni shqiptar; riparimin dhe remontet e mesme dhe kapitale te makinave elektrike te cdo tipi fuqie e tensioni, te motorrave dhe transformatoreve elektrike, transformatoreve te tensionit te larte, furrave elektrike, reaktoreve te cdo tipi si dhe te gjitha paisjeve elektrike; konsulence, revizion, ekspertize, vleresime te kapitaleve dhe gjendjes, plan-bizneseve, projekte zhvillimi dhe studime te fektiviteteve ekonomike, percaktimi i prioriteteve ne fusha te ndryshme te ekonomise etj.*

*Projektim, zbatim, mirembajtje, dhe asistence teknike te impianteve elektrike ne pergjithsi per tensionin e mesem, te ulet, dhe speciale, si; impiante te automatizime industriale te renda, impiante te trasmetimit dhe trasformimit te energjise, impiante te aspirimi dhe klimatizimi, impiante ndriqimi per institucionet publik, impiante te energjise alternative, impiante te mbrojtjes nga ngarkesat atmosferike, impiante portash, barrjerash dhe kontrollit te dedikuar, impiante kundra grabitjes, zjarrit, permbytjeve dhe gazrave, impiante videovezhgimi TVCC dhe speciale, impiante per trasmetim te dhenash dhe telekomunikacioni, etj.*

*Sherbime ne fushen e pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme, qe do te vleresohen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe te bleje pjesemarrje ne kapitale themeltare te shoqerive te tjera qe kane objekt te ngjashem apo te afert me te vetinduke perfshire pa u kufizuar qiradhenie, administrim, menaxhim, mirembajtje, riparim, ndermjetesim etj., per vete shoqerine apo te Tretet, ne territorin e Republikes se Shqiperise apo jashte saj.*

*Veprimtari ne fushen e ndertimit, zbatim, projektim, kolaudim etj. Projektim,ndertimit, dhe mirmbajtje te centraleve gjeneruese per prodhimin e energjise elektrike nga burime te rinovueshme si era ose dielli.*

*Realizim te impjanteve fotovoltaike dhe eolike per gjenerimin e energjise elektrike”.*

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit të Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

### Neni 4 Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT

### Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 10.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin eshoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Anri Lushnjari është zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 6.000 lekë, që përbën 60% të kapitalit themeltar të shoqërisë kurse



A2022051400168033528

2. Ortaku themeluese Albjon Dule eshte zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 4.000 lekë, që përbën 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku eshte pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

## Neni 6

### Kuotat

#### Te drejtat dhe detyrimet e lidhura

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakëve qe do te mbahet ne seline e Shoqërisë nen pergjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakëve").

Regjistri i Ortakëve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesisë se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

## Neni 7

### Transferimi i Kuotave

- 7.1. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakëve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi te gjithë apo nje pjese te kuotes ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortakë do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.
- 7.2. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t`u transferoje kuoten dhe kushtet esenciale qe do te aplikohen per transferimin.
- 7.3. Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.
- 7.4. Secili prej Ortakëve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
- 7.5. Administratoret brenda 10 diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.6. Nese me shume se nje Ortakë ushtrojne te drejta e parablerjes se kuotes, ata do te blejne kuoten ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.7. Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak si me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuoten e tij do te jete i lire t`ia transferoje kete kuote personit/ave te percaktuar prej tij.
- 7.8. Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtuar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuoten objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit 1 (nje) mujor te percaktuar me siper.
- 7.9. Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqërine.



A2022051400168033528

#### Neni 8

##### Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuota e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.

Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

#### Neni 9

##### Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

### KAPITULLI III

### ORGANET E SHOQERISE

#### Neni 10

##### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katërmbëdhjetë) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.



A2022051400168033528

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakëve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

## Neni 11

### Organi Administrues / Administratoret

Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i vetem i shoqërisë me mandat 5 vjeçar:

- **Z.ANRI LUSHNJARI**, atësia Stavri, amësia Dashmira, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje, Lushnjë dhe banues në TIRANË, me adresë Xhezmi Delli; Nd. 22; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 17/04/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034719599 dhe nr. personal I20417139W.

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.

Administratori do te:

- administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
- perfaqesoje Shoqerine;
- kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;



A2022051400168033528

- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
  - (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
  - (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
  - (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.
- Administratori mund te autorizojte persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorine e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje.  
Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

#### Neni 12

##### Kontrolli i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeruje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

### KAPITULLI IV

#### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

#### Neni 13

##### Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjet) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

#### Neni 14

##### Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te paktën 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

#### Neni 15

##### Dividendet

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

### KAPITULLI V

#### PRISHJA - LIKUIDIMI

#### Neni 16

##### Prishja e Shoqerise

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

#### Neni 17

##### Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedurese se likuidimit.



A2022051400168033528

**Neni 18**  
**Dispozita Perfundimtare**

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar. Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesisie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose çdo funksionari tjetër nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

*Për ndjekjen e të gjithë procedurave në lidhje me regjistrimin fillestar të Shoqërisë dhe akteve përkatëse në Regjistrin Tregtar (QKR) Z.Anri Lushnjari, mund të paraqitet e veprojë veçmas apo së bashku me të drejta e kompetenca të plota për nënshkrimin dhe dorëzimin e çdo aplikimi, kërkesë dhe/ose dokumenti që konsiderohet se duhet paraqitur pranë Regjistrin Tregtar për kompletimin e regjistrimit.*

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhet Shqipe

**ORTAKET THEMELUES**

**ANRI LUSHNJARI**

Anri Lushnjari!

**ALBJON DULE**

Albjon Dule

**NOTER**  
**ALKET Z.MANCKA**

